



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1709/4 prot

Datë, 21.09.2021

V E N D I M
K.P.P. 654/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.09.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-04485-09-02-2021 me objekt: Loti 10 “*Shtretër spitalor*”, me fond limit 31.533.866,67 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë
Rruga e Dibrës, Nr.372, Tiranë

Ankimues:

“O.E.S Distrimed” SHPK
Bulevardi “Bajram Curri”, Rruga “Nikollë Kaçorri”, ND 1, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”,
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, neni 24 e vijues

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.09.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-04485-09-02-2021 me objekt: Loti 10 “Shtretër spitalor”, me fond limit 31.533.866,67 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

II.2. Në datën 10.09.2021 operatori ekonomik “O.E.S Distrimed” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr.2327/8 prot., datë 17.09.2021, protokolluar me tonën me nr.1709/3 prot., datë 17.09.2021 me objekt “Kthim përgjigje mbi Formularin e Ankesës të administruar pranë Autoritetit Kontraktor me nr.2327/1 prot., datë 10.09.2021 nga OE “O.E.S Distrimed SHPK”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II.5. Referuar shkresës së mësipërme të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes “O.E.S Distrimed SHPK” dhe e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“Specifikimi i kërkuar: “Krevat Spitalor ICU me 3 motore për pozicionime të ndryshme, ndryshimi i lartësisë së kokës, zgjatjes së gjatësisë dhe lartësisë për këmbët. Për sa më sipër kërkojmë që ky specifikim të modifikohet në: Krevat Spitalor me 3 motore për rregullimin e seksionit të shpinës, seksionit të këmbëve, lartësisë.”

KSHA vendosi: Bëhet: “Krevat Spitalor me 3 motore për rregullimin e seksionit të shpinës, seksionit të këmbëve, lartësisë.”

Specifikimi i kërkuar: “Baza mbajtëse e dyshekut me 4 pjesë plastike PE për qëndrueshmëri më të lartë/e laminuar kompakt. Baza mbajtëse e dyshekut është plastike e laminuar kompakte”. Këto dy specifikime janë konfuzuese dhe kontradiktore me njëra-tjetrën. Kërkojmë që të përcaktohet materiali i bazës mbajtëse të dyshekut ose plastike PE ose e laminuar kompakte. Ose të hiqen si specifikime, nëse lloji i materialit nuk përbën rëndësi.

KSHA vendosi: Bëhet: Materiali i bazës mbajtëse të dyshekut ose plastike PE ose e laminuar kompakte ose ekuivalente duke garantuar qëndrueshmëri të lartë (me autodeklaratë).

Specifikimi i kërkuar: “Shtrirja e lartësisë: afërsisht 380 – 850 mm”. Për sa më sipër kërkojmë që ky specifikim të modifikohet në: “Lartësia të jetë e rregullueshme në diapazonin: afërsisht 500 – 750 mm”

KSHA vendosi: Bëhet: “Lartësia të jetë e rregullueshme në diapazonin: afërsisht 500 – 750 mm.

Specifikimi i kërkuar: “Kapaciteti i peshës mbajtëse: 230 – 250 kg”. Për sa më sipër kërkojmë që ky specifikim të modifikohet në “Kapaciteti i peshës mbajtëse: 200 – 250 kg”.

KSHA vendosi: Bëhet: “Kapaciteti i peshës mbajtëse: 200 – 250 kg.”

Për artikullin nr.3 “Shtrat pacienti me kontroll manual” disa nga specifikimet e kërkuara janë të paqarta ose kontradiktore me njëra-tjetrën. Prandaj kërkojmë rishikimin e tyre si më poshtë:

1) Specifikimet e mëposhtme:

- Përmasat afërsisht 2150 x 1000 x 680 mm
- Lartësia maksimale dhe minimale e krevatit 50 – 54 cm.

Janë të paqarta dhe kontradiktore me njëra tjetrën, konkretisht me specifikimin e parë lartësia kërkohet afërsisht 68 cm ndërkohë në specifikimin e dytë lartësia kërkohet 50 – 54 cm, pra lartësia 68 cm nuk është e përfshirë në këtë diapazon.

Bëhet: “Përmasat afërsisht 2150 x 1000 x 50-54 cm dhe “Lartësia minimale dhe maksimale e krevatit: 50 – 54 cm (pa dyshek).”

3) Specifikimet e mëposhtme:

- Përmasat për gjendjen e ulët: 50-60 x 1.5-2 mm*
- Përmasat për gjendjen e lartë: 40 – 50 x 30 x 1.5 mm*

Janë të paqarta përmasat e asnjë pjese të shtratit të pacientit nuk ndryshojnë sipas gjendjeve apo pozicionimeve të ndryshme. Kërkojmë sqarimin e tyre ose heqjen e këtyre specifikimeve.

Argumentim AK: “AK për pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomikë, duke mos shkaktuar paqartësi pranon heqjen e këtij specifikimi teknik, pasi vendosja e specifikimit teknik të rregullimit të gjurit, plotëson kërkesat e shërbimit, pa përcaktuar përmasa fikse.”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “O.E.S Distrimed” SHPK dhe me shkresën Nr.2327/8 prot., datë 17.09.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës.

Konkretisht, në kthim-përgjigjen e autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimet si vijon:

“[...] “Specifikimi i kërkuar: “Krevat Spitalor ICU me 3 motore për pozicionime të ndryshme, ndryshimi i lartësisë së kokës, zgjatjes së gjatësisë dhe lartësisë për këmbët. Për sa më sipër kërkojmë që ky specifikim të modifikohet në: Krevat Spitalor me 3 motore për rregullimin e seksionit të shpinës, seksionit të këmbëve, lartësisë.”

KSHA vendosi: Bëhet: “Krevat Spitalor me 3 motore për rregullimin e seksionit të shpinës, seksionit të këmbëve, lartësisë.”

Specifikimi i kërkuar: “Baza mbajtëse e dyshekut me 4 pjesë plastike PE për qëndrueshmëri më të lartë/e laminuar kompakt. Baza mbajtëse e dyshekut është plastike e laminuar kompakte”. Këto dy specifikime janë konfuzuese dhe kontradiktore me njëra tjetrën. Kërkojmë që të përcaktohet materiali i bazës mbajtëse të dyshekut ose plastike PE ose e laminuar kompakte. Ose te hiqen si specifikime nëse lloji i materialit nuk përbën rëndësi.

KSHA vendosi: Bëhet: Materiali i bazës mbajtëse të dyshekut ose plastike PE ose e laminuar kompakte ose ekuivalente duke garantuar qëndrueshmëri të lartë (me autodeklaratë).

Specifikimi i kërkuar: “Shtrirja e lartësisë: afërsisht 380 – 850 mm”. Për sa më sipër kërkojmë që ky specifikim të modifikohet në: “Lartësia të jetë e rregullueshme në diapazonin: afërsisht 500 – 750 mm”

KSHA vendosi: Bëhet: “Lartësia të jetë e rregullueshme në diapazonin: afërsisht 500 – 750 mm.

Specifikimi i kërkuar: “Kapaciteti i peshës mbajtëse: 230 – 250 kg”. Për sa më sipër kërkojmë që ky specifikim të modifikohet në “Kapaciteti i peshës mbajtëse: 200 – 250 kg”.

KSHA vendosi: Bëhet: “Kapaciteti i peshës mbajtëse: 200 – 250 kg.”

Për artikullin nr.3 “Shtratit pacienti me kontroll manual” disa nga specifikimet e kërkuara janë të paqarta ose kontradiktore me njëra-tjetrën. Prandaj kërkojmë rishikimin e tyre si më poshtë:

2) Specifikimet e mëposhtme:

- Përmasat afërsisht 2150 x 1000 x 680 mm
- Lartësia maksimale dhe minimale e krevatit 50 – 54 cm.

Janë të paqarta dhe kontradiktore me njëra tjetrën, konkretisht me specifikimin e parë lartësia kërkohej afërsisht 68 cm ndërkohë në specifikimin e dytë lartësia kërkohej 50 – 54 cm, pra lartësia 68 cm nuk është e përfshirë në këtë diapazon.

Bëhet: “Përmasat afërsisht 2150 x 1000 x 50-54 cm dhe “Lartësia minimale dhe maksimale e krevatit: 50 – 54 cm (pa dyshek).”

3) Specifikimet e mëposhtme:

- Përmasat për gjendjen e ulët: 50-60 x 1.5-2 mm
- Përmasat për gjendjen e lartë: 40 – 50 x 30 x 1.5 mm

Janë të paqarta përmasat e asnjë pjese të shtratit të pacientit nuk ndryshojnë sipas gjendjeve apo pozicionimeve të ndryshme. Kërkojmë sqarimin e tyre ose heqjen e këtyre specifikimeve.

Argumentim AK: “AK për pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomikë, duke mos shkaktuar paqartësi pranon heqjen e këtij specifikimi teknik, pasi vendosja e specifikimit teknik të rregullimit të gjurit, plotëson kërkesat e shërbimit, pa përcaktuar përmasa fikse.”

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.”

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
- ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 2 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-04485-09-02-2021 me objekt: Loti 10 “Shtretër spitalor”, me fond limit 31.533.866,67 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.10.2021 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.
 2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
 3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri